



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kulturës
Periudha raportuese	Tetor, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

- Gjatë muajit shtator janë realizuar shumë takime dhe aktivitete të planifikuara dhe të paplanifikuara me partnerë, institucione dhe organizata vendore dhe ndërkombëtar bazuar në planin e punës.
- Drejtoria e Kulturës dhe institucionet varëse, kanë realizuar planin operativ të punës, por edhe angazhime të tjera sipas nevojës.
- *Shënim (pjesa më e madhe e takimeve qoftë me institucione, qoftë me individë, është mbajtur përmes platformës digjitale ZOOM për shkak të COVID -19, gjithashtu edhe takime fizike sipas nevojës).*

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.

Sektori i Kulturës:

- Inicimi, koordinimi i aktiviteteve të prokurimit, sipas planit të prokurimit dhe atij buxhetor;

- Planifikimi i takimeve me institucionet relevante lidhur me kulturën, trashëgiminë kulturore, si dhe promovimin e turizmit, ministritë relevante, organizata etj.;
 - Përcjellja e punimeve përgjatë implementimit të kontratës në Strehimoren e artit (Bregu i Diellit);
 - Monitorimi i implementimit të kontratës “Rivitalizimi i rrugës “Mehmet Kaçuri”” (rruga Model);
 - Finalizimi i “detyrës projektuese për ruajtjen, adaptimin konservimin e ish-bibliotekës “Hivzi Sulejmani” në Galeri të Qytetit;
 - Monitorimi i implementimit të kontratës “Furnizim dhe montim i ruajtjes së lëndës arkivore”;
 - Monitorimi i zbatimit të kontratës “Furnizim me Libra”;
 - Adresimi i kërkesave në shtab për dhënie të pëlqimeve për aktivitetet kulturore;
 - Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
 - Përgatitja e raportit mujor;
 - Takimet e vazhdueshme me përfaqësues të Manifestës;
 - Koordinimi i punëve rreth kërkesave nga institucionet vartëse të drejtorisë;
 - Takimet me krijuesit e ueb-faqes për promovimin e turizmit “In Prishtina”;
 - Monitorimi i aktiviteteve të subvencionuara nga drejtoria;
- Vlerësimi i projekteve nga komisioni për “Thirrje për kulturë, faza II” dhe thirrjes për TPQ “Dodona”, si dhe përgatitja e listave, dokumentacioneve, qasjes në sistem për komisionet.

Qendra Kulturore e Fëmijëve

- Realizimi festivalit “ Ylberi i Prishtinës” - Edicioni i 18-të.

Biblioteka “Hivzi Sulejmani”

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;

- Shërbimi me lexues;
- Huazimi i librit;
- Përgatitja dhe planifikimi i programit të punës për vitin 2020;
- Mirëmbajtja e ueb-faqes së bibliotekës.

Arkivi Komunal

- Rregullimi i materialit nga Drejtoria e Pronës;
- Sistemimi në depot e arkivit të lëndës së rregulluar.

TQP "Dodona"

- Realizimi i shfaqjeve të rregullta në TEATRIN PËR FËMIJË, të shtunën, prej orës 12:00 dhe të dielën prej orës 12:00: " "Mik-mik" (PREMIRË), "Fjalët magjike", "Liza në botën e çudirave" dhe "Mustaqoshi larosh";
- Realizimi i shfaqjes mysafire "Unë jam vetë grua" në SKENËN E MBRËMJES, që do të jetë pjesë e festivalit "Kosovo Showcase 2020";
- Komunikimi me organizatën partnere OJQ "Fondacioni për të drejtat e kafshëve" për realizimin e shfaqjes për fëmijë "Teo, qeni i rrugës", që ka fituar subvencion nga Komuna e Prishtinës;
- Fillimi i provave të shfaqjes për fëmijë "Teo, qeni i rrugës", në kooproduksion me OJQ "Fondacioni për të drejtat e kafshëve", që ka fituar subvencion nga Komuna e Prishtinës;
- Promovimi i programit mujor dhe i shfaqjeve në rrjetet sociale;
- Komunikimi me donatorët potencialë dhe palë të ndryshme.

3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.*

Spektori i Kulturës:

- Vizitat në terren nga organi mbikëqyrës dhe zyrtarë të drejtorisë për implementimin e kontratës për vazhdimin e punimeve përfundimtare në Strehimore (Bregu i Diellit);

- Mbikëqyrja dhe përcjellja e aktivitetit, "Shërbimet konsulente" nga organi mbikëqyrës;
- Monitorimi në vazhdimin e implementimi të aktivitetit "Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore, në arkivin e Prishtinës";
- Vizita në terren dhe monitorimi i implementimit të aktivitetit " Rivitalizimi i rrugës "Mehmet Kaçuri" " (rruga model);
- Mbajtja e takimeve të rregullta virtuale me përfaqësuesit e Manifestës;
- Koordinim dhe mbikëqyrje e fillimit të implementimit të kontratës "Furnizim me libra" në bibliotekën "Hivzi Sulejmani";
- Përgatitja e Statutit të ansamblit të qytetit edhe pas komenteve të bëra nga Zyra ligjore e kabinetit të kryetarit;
- Finalizimi i detyrës projektuese për ish-bibliotekën "Hivzi Sulejmani";
- Nënshkrimi i marrëveshjes mes Komunës së Prishtinës, Agjencisë Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe për bashkëfinancimin e Parkut të aventurave;
- Adresimi për shtab i kërkesave për dhënie të pëlqimeve për aktivitetet kulturore;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore dhe shkarkimi nga intraneti;
- Kontrollimi i raporteve të pranuar të projekteve të subvencionuara;
- Përpilimi i listave dhe kontrollimi i dokumentacioneve të 230 aplikantëve për thirrjen "Thirrje për Kulturë, faza II" dhe "Thirrje për TQP "Dodona"" për komisionin për shqyrtim të kërkesave;
- Mbajtja e takimeve të komisionit për vlerësim të projekteve, të 2 thirrjeve "Thirrje për Kulturë, faza II" dhe "Thirrja për TQP "Dodona"";
- Përgatitje e dokumentacioneve për anëtarët e dy komisioneve, si dhe dhënia e qasjes online në sistem;
- Koordinim të vazhdueshëm me dy komisionet e subvencioneve;
- Koordinimi i punëve për procedim tutje të kërkesave e institucioneve vartëse të Drejtorisë së Kulturës;

Qendra Kulturore e Fëmijëve

Realizimi i festivalit “Ylberi i Prishtinës” - Edicioni i 18-të, për shkak të situatës nga Covid -19, këtë vit u realizua në formë virtuale, ku shtetet pjesëmarrëse në këtë edicion ishin: Meksika, Finlanda, Kyrgystani, Azerbajxhani, Ukraina, Kroacia, Rumania, Hora Arbëreshe – Itali, Bullgaria, Turqia, Mali i Zi, Shqipëria dhe Kosova. Për herë të parë festivali kishte karakter garues, ku kishte edhe jurinë profesionale prej tre anëtarëve për vlerësim.

Biblioteka “ Hivzi Sulejmani”

Biblioteka “Hivzi Sulejmani” pas punës dymujore të ofrimit të shërbimeve, huazimi i librit ka rifilluar punën me sallat e leximit nga dita e premte, më 9 tetor 2020. Ky veprim u bë në përputhje me masat e udhëzimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe të Ministrisë së Shëndetësisë, të aprovuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Kulturës dhe organet tjera të Komunës së Prishtinës.

Pasi janë bërë të gjitha përgatitjet për kushte pune në situatë pandemie, puna rifilloi me 40% të kapaciteteve të hapësirave për lexim, që i bie gjithsej 135. Po punohet pesë ditë të javës, nga ora 8.15 deri në orën 16.00. Nëse shkon puna sipas planit, do të fillojmë me orar të plotë do të thotë nga 8.00 – 19.00, në dy ndërtesa, duke përfshi këtu edhe ditën e shtunë (8.00-13.00).

Krahas përgatitjeve tona që puna të shkojë sa më mirë, lexuesit, përkatësisht anëtarët e kësaj biblioteke janë njoftuar me masat që detyrimisht duhet të respektohen, siç janë:

- Bartja e maskës në ambiente është e detyrueshme, askush pa të nuk mund të hyjë brenda;
- Respektimi i distancës së paku 1.5m është obligues;
- Lexuesve do t’u matet temperatura në hyrje të ndërtesës së bibliotekës;
- Dezinfektuesi i duarve do të jetë në hyrje të objektit dhe përdorimi i tij është i domosdoshëm;
- Secila tavolinë ka numrin e vetë. Lexuesi duhet ta merr së pari numrin në librari pastaj të ulet në vendin e caktuar. Personi që liron ulësen është i obliguar që numrin e tavolinës ta dorëzojë te librari;
- Ndalohet mbledhja në grupe (nga 2 e më shumë) në të gjitha hapësirat e bibliotekës;
- Ndalohen shëtitjet e lëvizjet e panevojshme në hapësirat brenda objektit;
- Kushdo nga përdoruesit e hapësirave që shkel këto rregulla, do të largohet nga hapësirat e bibliotekës;
- Askush nga përdoruesit e librave nuk mund të shërbehet vetë. Këtë shërbim e bënë vetëm librari.

U realizua "Projekti i librit", mbështetur nga Drejtoria për Kulturë me 1327 tituj dhe 48270 ekzemplarë. Një pjesë e librave u sollën në bibliotekë, më 28.10.2020. Të pranishëm në pranimin e librave ishin edhe drejtoresha e DK, Blerta Basholli dhe përfaqësues të tjerë nga Komuna e Prishtinës. Kjo ngjarje u përcjell nga mediat dhe lexuesit e kryeqytetit.

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;
- Huazimi i librit;
- Përgatitja e raporteve mujore;
- Mirëmbajtja e ueb-faqes së bibliotekës.

TQP "Dodona"

- Pas lejimit të punës së teatrove nga Qeveria e Republikës së Kosovës, TQP "Dodona" ka filluar me përgatitjet për realizimin e repertorit për muajin tetor dhe i ka ndërmarrë masat e duhura për t'i përfillur udhëzimet në parandalimin e COVID-19 në teatër, ku pos dezinfektimit të hapësirave, bartjes së maskave dhe ruajtjes së distancës, teatrot janë lejuar të përdorin vetëm 40% të ulëseve, që në TQP "Dodona" i bie vetëm 44 ulëse. Për një menaxhim më të mirë të kësaj situate, është ndryshuar edhe orari i shfaqjeve në TEATRIN PËR FËMIJË, ku shfaqjet jepen të shtunën dhe të dielën, me nga një termin, prej orës 12:00. Në këtë kontekst është bërë edhe njoftimi i publikut me orarin e ri, si dhe njoftimi i publikut që biletat mund të blihen dhe rezervohen vetëm gjatë ditëve të javës, e në ditët kur ka shfaqje vetëm mund të blihen ato që janë rezervuar gjatë javës, gjë që është ndërmarrë për të mos shkaktuar grumbullime dhe tollovi në teatër në ditët kur ka shfaqje;
- Duke e pasur parasysh numrin e vogël të ulëseve në dispozicion (44), drejtori i TQP "Dodona", Visar Krusha, ka marrë vendim që shfaqjet të cilat janë prodhuar në koproduksion dhe shfaqjet mysafire që do të shfaqen në programin e TQP "Dodona", të lirohen nga pagesa e tarifës për Dodonën (që kalkulohet në bazë të numrit të shitur të biletave, sipas çmimoreve të TQP "Dodona" dhe marrëveshjeve përkatëse për koproduksion apo shfaqje mysafire);
- Përpilimi dhe dizajnimi i programit mujor;
- Promovimi i programit mujor dhe i shfaqjeve në rrjetet sociale dhe ueb-faqen e TQP "Dodona";
- Prej 16 tetorit, janë realizuar 5 shfaqje në skenën TEATRI PËR FËMIJË, 1 prej tyre ka qenë premierë e mbyllur për mysafirë e shfaqjes "Mik-mik", me bileta falas, të tjerat janë dhënë për publik të gjerë, çdo të shtunë dhe të diel, prej orës 12:00.

Numri i përgjithshëm i shikuesve është 205. Titujt e shfaqjeve të realizuara në TEATRIN PËR FËMIJË janë: “Mik-mik” dhe “Liza në botën e çudirave”; Pasi aktorja që luan në shfaqjen “Mustaqoshi larosh”, ka rezultuar pozitiv në testin serologjik për COVID -19, reprizat e planifikuara të kësaj shfaqjeje, më 31 tetor dhe 1 nëntor, janë anuluar, ndërsa aktorja në fjalë është futur në vetizolim për dy javë;

- Janë realizuar 2 shfaqje në skenën SKENA E MBRËMJES, me gjithsej 88 shikues, të dy këto shfaqje mysafire, që janë dhënë si pjesë e festivalit “Kosovo Showcase 2020”, organizuar nga Qendra Multimedia, me hyrje falas. Titujt e shfaqjeve në SKENËN E MBRËMJES janë: “Unë jam vetë grua” dhe “02.08.1944”;
- Komunikimi me organizatën partnere OJQ “Fondacioni për të drejtat e kafshëve” dhe bashkëpunëtorët për realizimin e shfaqjes për fëmijë “Teo, qeni i rrugës”, i cili ka fituar subvencion nga Komuna e Prishtinës;
- Kanë filluar provat e shfaqjes për fëmijë “Teo, qeni i rrugës”, premiera e së cilës planifikohet të jepet në nëntor;
- Nënshkrimi i marrëveshjes së mirëkuptimit me OJQ “Fondacioni për të drejtat e kafshëve” për vendosjen e kutisë së donacionit për ushqyerjen e kafshëve endacake, në hapësirat e TQP “Dodona”;
- Komunikimi me donatorët potencialë dhe palë të ndryshme;
- Adresimi i kërkesave për shfrytëzim të hapësirës.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

Sektori i Kulturës

- Vazhdimi i përgatitjeve konform protokollit të “Manifesta 14”, Bienale Evropiane e Artit Bashkëkohor;
- Implementimi dhe koordinimi me organin mbikëqyrës dhe operatorin përgjatë zhvillimit të punimeve “Rivitalizimi i rrugës “Mehmet Kaçuri”” (rrugës Model);
- Vazhdimi i procedurave administrative, Konkurs - projektimi për konservimin dhe adaptimin e shtëpisë shkollë në Muzeun e shtëpive shkolla, (Lagjja e Herticëve, Prishtinë);

- Ndërtimi i Qendrës kulturore për të rinj - Bibliotekës në lagjen "Kodra e Trimave, në fazën e marrjes së lejes ndërtimore;
- Rregullimi i ambientit për ekspozimin e veprave të artit, janë duke u zhvilluar punimet në strehimore "Bregu i Diellit", punimet janë në përfundim e sipër;
- Aktiviteti "Furnizim me libra" fillimi i implementimit, mbikëqyrja dhe monitorimi;
- Mbikëqyrja e implementimit sipas kontratës për aktivitetin "Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore në Arkivin Komunal të Prishtinës;
- Renovimi i bibliotekës "Hivzi Sulejmani", si degës përkujtimorja në Taukbaçë, në fazën e koordinimit të organit mbikëqyrës dhe operatorit për fillimin e punimeve;
- Finalizim i detyrës projektuese për Galerinë e qytetit;
- Koordinimi dhe takimet e rregullta për fillimin e implementimit të projektit për Parkun e aventurave;
- Funkcionalizimi i Zyrës informative.

Qendra Kulturore e Fëmijëve

- Puna në sektorë të QKF-së, me numër deri në 6 fëmijë.

Arkivi Komunal

- Rregullimi i materialit arkivorë, fondi Komuna e Prishtinës - Drejtoria e Pronës;
- Skenimi dhe digjitalizimi i objekteve të ndryshme në komunën e Prishtinës;
- Sistemimi i kutive arkivore nëpër depot e Arkivit.

TQP "Dodona"

- Komunikimi me organizatën partnere OJQ "Fondacioni për të drejtat e kafshëve" dhe bashkëpunëtorët për realizimin e shfaqjes për fëmijë "Teo, qeni i rrugës", i cili ka fituar subvencion nga Komuna e Prishtinës;
- Komunikimi me donatorët potencialë dhe palë të ndryshme;
- Provat e shfaqjes për fëmijë "Teo, qeni i rrugës", premiera e së cilës planifikohet të jepet në nëntor.

4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

4.1.3 Takimet me palë

Sektori i Kulturës:

- Takime e rregullta virtuale me përfaqësuesit e Manifestës;
- Takimet e rregullta me operatorët me gjithë kontratat e hapura nga organet mbikëqyrëse;
- Takim i grupit punues për Planin zhvillimor komunal;
- Takime me palë, duke dhënë rekomandime bazuar në kërkesat, shqetësimet e tyre rreth subvencioneve, përfituesve të projekteve, pëlqimeve, udhëzime sipas nevojave të palëve.

5. Takimet me institucione të tjera

Arkivi Komunal

Takim me përfaqësuesit e Universitetit të Prishtinës në lidhje me marrëveshje bashkëpunimi, me theks të veçantë për mundësinë e rregullimit dhe të digjitalizimit të lëndës arkivore të fondit “Mësimi shtëpi – shkollë, të viteve të 90 –ta”.

6. Diskutime publike / takimet me qytetarë

6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

Arkivi Komunal

- Gjatë muajit tetor 2020, kemi pasur gjithsej 47 kërkesa, në të cilat jemi përgjigjur brenda afateve ligjore.

6.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

7. Takime të tjera

Arkivi Komunal

- Intervistë e u.d. e drejtorit të Arkivit, z. Makolli me gazetarët e KTV-së lidhur me të arriturat e Arkivit Komunal të Prishtinës.

8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

Arkivi Komunal

- Gjatë implementimit të planit po hasim në vështirësi të mëdha, si pasojë e pandemisë COVID -19, si dhe mungesës së stafit, sidomos në shërbimin e rregullimit të lëndës arkivore. Andaj, po e përsërisim prapë se kemi nevojë të madhe për së paku 3 punëtorë/e.

9. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të Drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.

Arkivi Komunal

- Rekrutimi i stafit në trajnime të ndryshme, të cilat kanë karakter për ngritjen e cilësisë profesionale.

Biblioteka “Hivzi Sulejmani”

- Rekrutimi i punonjësve të rinj;
- Renovimi i objektit në degën “Pallati i Rinisë”;
- Renovimi i objektit në degën “Përrallat” dhe “Lektyra”.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

- Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues.

Spektori i Kulturës

- Përfundimi i vlerësimit konform rregullores dhe publikimi i projekteve të vlerësuara nga komisioni, të thirrjes publike për fazën e dytë për Kulturë dhe thirrjes publike për teatrin “Dodona”;
- Përcjellja e të gjitha aktiviteteve të iniciuara nga drejtoria, të cilat janë në implementim me kontrata të hapura, si dhe ato të cilat fillojnë implementimin, kontaktet e vazhdueshme dhe koordinim i punëve me

organet mbikëqyrëse, duke përfshirë edhe vizitat në terren rreth implementimit;

- Inicimi i proceduarve të reja të prokurimit bazuar në planin e punës së drejtorisë;
- Monitorimi i punës së institucioneve vartëse;
- Shqyrtimi i lëndëve dhe kërkesave ditore;
- Vazhdimi i përgatitjeve, koordinimi i punëve konform protokollit të “Manifesta 14” dhe Komunës së Prishtinës, Bienale Evropiane e Artit Bashkëkohor;
- Vazhdimi i koordinimit të punëve rreth rihapjes së Zyrës informative turistike, si dhe diskutimet për hapjen e pikës së re që planifikohet në Stacionin e Autobusëve;
- Përpilimi i kontratave dhe vendimeve të përfituesve;
- Përgatitja e Festeve të Fundvitit (nëse lejohen aktivitetet kulturore bazuar në situatën e pandemisë).

Arkivi Komunal

- Vazhdimi i rregullimit të fondit të Komunës së Prishtinës, Drejtoria e Pronës.
- Vazhdimi i skenimit të projekteve të ndryshme.

Qendra Kulturore e Fëmijëve

- Përgatitja e solistëve për pjesëmarrje në festivale në Kosovë dhe jashtë saj.

Biblioteka “ Hivzi Sulejmani”

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;
- Huazimi i librit;
- Përgatitja e raporteve mujore.

TQP “Dodona”

- Përpilimi dhe dizajnimi i programit mujor;

- Realizimi i shfaqjeve të rregullta në TEATRIN PËR FËMIJË, të shtunën, prej orës 12:00 dhe të dielën prej orës 12:00: “Mik-mik”, “Teo, qeni i rrugës” (premierë), “Liza në botën e çudirave” dhe “Fjalët magjike”;
- Komunikimi me organizatën partnere OJQ “Fondacioni për të drejtat e kafshëve” dhe bashkëpunëtorët për realizimin e shfaqjes për fëmijë “Teo, qeni i rrugës”, që ka fituar subvencion nga Komuna e Prishtinës;
- Promovimi i programit mujor dhe i shfaqjeve në rrjetet sociale dhe ueb-faqen e TQP “Dodona”;
- Komunikimi me donatorët potencialë dhe palë të ndryshme.

11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

Arkivi Komunal:

- Arkivi i Prishtinës gjatë këtij muaj ka përcjellë punët dhe mbikëqyrjen e projektit, i cili ka nisur së implementuari, projekti për sigurinë e lëndës arkivore.